

DRAFTI I RI I LIGJIT PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME LEHTËSON VOTIMIN PËR DIASPORËN | FAQE 4-5



Javën e kaluar Komisioni Ad Hoc për reformë zgjedhore, i themeluar nga Kuvendi i Kosovës, ka përmbyllur punën, duke hartuar draftin e ri të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. E veçanta e tij ka të bëjë me

votimin e mërgatës në zgjedhjet në Kosovë. Sipas këtij draftligji, në zgjedhjet e ardhshme parlamentare bashkatdhetarët do të evidentohen si votues në mënyrë elektronike, ndërkaq ambasadat dhe konsullatat e

Kosovës gjatë zgjedhjeve do të shndërrohen në qendra të votimit. Kjo punë do t'u kursejë bashkatdhetarëve tanë buxhet dhe kohë dhe do të mundësojë që fletëvotimet të arrijnë shpejt e sigurt

NISIN HETIMET PËR SULMIN NDAJ GAZETARIT SYLA | FAQE 7



KOSOVA SHPALL 14 PRILLIN DITË TË TË MBIJETUARVE TË DHUNËS SEKSUALE GJATË LUFTËS | FAQE 6



RENOVA
 PUTZ
 Maqedoni
 Xhepçisht - Tetovë
 Gurëz-Ferizaj
 Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
 +389 44 487 755
 Fax: +389 44 487 200
 Mbx: +377 44 501 289
 E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
 GROUP SH.P.K.
 NDËRTIM
 PROJEKTIM
 SHITJE
 INFO: 049-111-101,
 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
 FABRIKA E LLAQEVE
 MITROVICË
 044/256-051
 044/367-061
 028/532-617
 STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
 info@kolegji.biznesi.com
 030 500 878 | 045 500 878
 044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
 VIENNA INSURANCE GROUP
 SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
 DEGA KOSOVË
 Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
 Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
 E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
 Digital Agency
 Endrit Shaqiri
 +38344685122
 Internet Website,
 Marketing...

AKTUALE



UKRAINA THOTË SE KA ZMBRAPSUR
 MBI 70 SULME RUSE | F. 2

SHQIPËRIA DHE KOSOVA
 LEHTËSOJNË EDHE MË SHUMË
 LËVIZJEN E LIRË | F. 5

QEVERIA MIRATON PROJEKTLIGJIN
 PËR PROGRAMIN IPA 2022,
 KOSOVA PËRFITON 62.25 MILIONË
 EURO NGA BE-ja | F. 3

EKONOMI



HARADINAJ: QEVERISË I KANË
 MBETUR TË PASHFRYTËZUARA
 478 MILIONË EURO VETËM NGA
 INVESTIMET KAPITALE | F. 8

BURSA SHOIPTARE E ENERGJISË
 (ALPEX), NJË HAP MË AFËR TREGUT
 TË PËRBASHKËT ENERGJETIK
 KOSOVË - SHQIPËRI | F. 8

SPORT



REALI TRIUMFON NDAJ CHELSEAT,
 FITON EDHE MILANI | F. 10

Ukraina thotë se ka zbrapsur mbi 70 sulme ruse

KIEV, 12 PRILL - Ukraina ka njoftuar se forcat e saj kanë zbrapsur dhjetëra sulme të forcave ruse në lindje tekta luftimet intensive po vazhdojnë përreth qytetit Bahmut. "Pavarësisht prej humbjeve të mëdha të pajisjeve dhe ushtarëve, armiku nuk po heq dorë nga lufta e agresionit. Po vazhdon t'i përqendrojë përpjekjet kryesore në kryerjen e operacioneve të ofensivës në zonat e Limanit, Bahmutit, Avdivit dhe Marinin", tha shtabi i përgjithshëm i ushtrisë ukrainase më 12 prill. Forcat ukrainase kanë zbrapsur 72 sulme gjatë ditës së kaluar, u tha në

deklaratë.

Serhiy Cherevatyi, komandant i forcave tokësore të Ukrainës, tha se situata në Bahmut është nën kontroll, duke shtuar se Kievi nuk do të lejojë që trupat e tij të rrethohen. Beteja disamujore për Bahmutin, që gjendet në rajonin lindor të Donjeckut, është shndërruar në një prej betejave më të përgjakshme të pushtimit rus të Ukrainës.

Në Uashington, sekretari amerikan i Mbrojtjes, Lloyd Austin, tha se Shtetet e Bashkuara do t'i hetojnë dokumentet e klasifikuara që kanë dalë në publik derisa të gjendet burimi. "Ne do të vazhdojmë të hetojmë dhe nuk

do të lëmë gur pa lëvizur derisa të gjendet burimi", tha Austin për gazetaret.

Dokumentet, që përfshijnë edhe informacione lidhur me përdorimin e municioneve nga Ukraina për sistemin raketor të artilerisë me lëvizshmëri të lartë (HIMARS) dhe armëve të tjera të avancuara, rrodhën në publik javën e kaluar.

Drejtori i Agjencisë Qendrore të Inteligjencës (CIA), William Burns, i ka quajtur rrjedhjet e informacioneve si gjë "shumë të pafat" duke mos ofruar detaje për atë që i cilësoi si hetime "shumë intensive" që po kryhen nga Pentagoni dhe Departamenti amerikan i Drejtësisë.



Rubin: Ka njerëz në Rusi që nuk duan ta shohin Maqedoninë e Veriut në BE



SHKUP, 12 PRILL - Zyrta i lartë i Departamentit amerikan të Shtetit, James Rubin, u ka thënë krerëve institucionalë në Maqedoni të Veriut se duhet të punojnë me vendosmëri për parandalimin e përhapjes së dezinformatave. Ai është takuar me kryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Dimitar Kovačevski, zëvendëskryeministrin e parë, Artan Grubi dhe ministrin e Mbrojtjes, Sllavjanka Petrovka, me të cilët ka diskutuar për dezinformata ruse dhe kineze dhe ndikimin e tyre ndaj gjendjes së sigurisë. "Është e

qartë se burimi kryesor i kërcënimit në këtë pjesë të botës është dezinformata e gjeneruar nga Rusia... presidenti (rus, Vladimir) Putin mendoi se mund ta pushtonte Ukrainën dhe ta ndante Evropën, por ai dështoi. Por kjo nuk do të thotë se Rusia nuk vazhdon ta përhapë 'helmin' e dezinformimit dhe ndarjes", ka thënë Rubini. Duke folur për Rusinë, Rubini ka thënë se është i sigurt se në Kremlin ka njerëz që nuk duan që Maqedonia e Veriut të përparojë në rrugën drejt

Bashkimit Evropian. "Jam i sigurt se ka njerëz në rajon, dhe në Kremlin, që nuk duan përparim në procesin që do t'i lejojë Maqedonisë së Veriut të ecë përpara drejt BE-së. Unë jam i sigurt se ata janë ulur diku duke menduar se çfarë të bëjnë për ta bërë atë një problem dhe gjithçka që mund të them është se qeveria këtu do të punojë me ne për të krijuar një qasje më të gjerë shoqërore për trajtimin e dezinformimit, si institucionet, ligjet, standardet e të tjera".

Escobari në Tiranë bën thirrje për kandidatë me integritet në zgjedhje

Tiranë, 12 prill - I dërguari i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, është takuar në Tiranë me krerë institucionalë pak para zgjedhjeve lokale të 14 majit në këtë shtet. Escobari është pritur nga presidenti Bajram Begaj, kryeministri Edi Rama dhe ministrja e Jashtme, Olta Xhaçka.

Ambasada Amerikane në Shqipëri ka thënë se thirrja e Escobarit për liderët ka qenë "të sigurojnë që kandidatët t'i përmbushin kërkesat e ligjit dhe t'i përmbushin pritshmëritë e qytetarëve shqiptarë për integritet të lartë".

Thirrje të ngjashme ka bërë edhe ambasadorja amerikane në Tiranë, Yuri Kim, ditë më parë. "Drejtuesit duhet të sigurohen që listat e tyre të kandidatëve t'i përmbushin

kërkesat e ligjit si dhe pritjet e qytetarëve shqiptarë për integritet të lartë. Strategjia kundër korrupsionit e presidentit (të ShBA-së, Joe) Biden, identifikon kërcënimin unik që paraqet korrupsioni për demokracinë dhe sigurinë tonë kombëtare", ka thënë Kim më 24 mars.

Ajo, gjithashtu, ka kërkuar nga partitë politike "të sigurohen që fushatat dhe aktivitetet zgjedhore të zhvillohen në mënyrë të drejtë, të rregullt dhe transparente, në përputhje me ligjin shqiptar dhe standardet ndërkombëtare".

Vizita e Escobarit është realizuar dy ditë para nisjes së fushatës zgjedhore.

Aktualisht partitë politike kanë regjistruar kandidatët dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve po kryen



verifikimin e tyre.

Partia Socialiste dhe koalicioni "Bashkë Fitojmë", në të cilin bëjnë pjesë "Partia e Lirisë" e Ilir Metës dhe një grup deputetësh demokratë - që udhëhiqen nga Sali Berisha - garojnë me kandidatë në 61

bashkitë e vendit.

Partia Demokratike ka dalë me kandidatë në vetëm 15 bashki, pasi nuk është arritur kompromis që dy grupimet brenda Partisë Demokratike të dalin me kandidatë të përbashkët.

Ndarja e thellë në PD është krijuar në maj të vitit 2021, kur ShBA-ja ka shpallur ish-kryeministrin Berisha si person të padëshiruar.

Lulzim Basha, që atëbotë ka qenë kryetar i partisë, pati marrë vendim për përjashtimin e Berishës nga grupi parlamentar. Diçka e tillë ka rezultuar me krijimin e strukturave paralele brenda partisë më të madhe opozitare, madje edhe në protesta të dhunshme.

Kandidatët e propozuar dhe të mbështetur nga Sali Berisha nuk do të garojnë nën logon e PD-së, por të koalicionit "Bashkë fitojmë", që drejtohet nga partia e së majtës e Ilir Metës - Partia e Lirisë.

Aktualisht thuhet se të gjitha bashkitë e vendit drejtohen nga Partia Socialiste për shkak se opozita i pati bojkotuar zgjedhjet lokale të vitit 2019.

Qeveria miraton Projektligjin për Programin IPA 2022, Kosova përfiton 62.25 milionë euro nga BE-ja

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 PRILL - Qeveria e Kosovës ka zhvilluar mbledhjen e saj të rregullt të mërkurën, në të cilën ka plotësuar dhe ndryshuar Programin Legjislativ të Qeverisë së Kosovës për vitin 2023 duke shtuar 12 projektligje. Po ashtu, është miratuar Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2022.

Kjo marrëveshje i mundëson Republikës së Kosovës që të përfitojë 62.25 milionë euro nga Bashkimi Evropian, të cilat do të zbatohen në projektet e kthimit dhe riintegritimit të komuniteteve, përkrahja për profesionet e lira në Kosovë, instrumentet e përafritimit dhe përkrahja për mjedisin dhe energjinë e gjelbër.

Sipas qeverisë, kjo mbështetje e Bashkimit Evropian përmes IPA-s konsiderohet si kontribut i veçantë për ta fuqizuar procesin e integritimit evropian të Republikës së Kosovës, posaçërisht duke ndihmuar në arritjen e obligimeve

të dala nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit.

Totali i mjeteve të dedikuara, duke përfshirë mjetet e Bashkimit Evropian, donatorëve dhe kontributin nga Qeveria e Republikës së Kosovës, është 91 milionë e 830 mijë euro.

Gjithashtu, kabineti qeveritar ka miratuar Projektligjin për Përfaqësimin e Institucioneve Shtetërore në Procedura Gjyqësore dhe Arbitrazh.

Ky projektligj përcakton rregullat e përfaqësimit të institucioneve të administratës shtetërore në procedura gjyqësore dhe arbitrazh, po ashtu rregullon edhe funksionimin dhe kompetencat e Avokaturës Shtetërore si dhe statusin juridik të avokatit të komunës.

Qeveria ka njoftuar se javën e kaluar Republika e Kosovës shënoi fitoren e tretë me radhë në arbitrazhin ndërkombëtar, duke kursyer 145 milionë euro nga vlera e pretenduar. Miratimi i këtij projektligji kontribuon në fuqizimin e mëtejshëm të institucioneve të drejtësisë.

Po ashtu, ministrat kanë aprovuar

analizën juridike për thjeshtimin, bashkimin ose eliminimin e lejeve dhe licencave në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Ekonomisë.

Në këtë mbledhje të qeverisë është miratuar edhe Rregullorja për Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë në Kuadër të Administratës Shtetërore. Po ashtu, është miratuar Udhëzimi Administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të Përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve. “Neni 9 i Udhëzimit ndryshohet dhe zbatimi i Udhëzimit do të zgjasë për periudhën 8 (tetë) vjeçare nga dita e hyrjes në fuqi. Gjatë vitit 2022 nga kjo masë afirmative kanë përfituar 4 375 çifte në nivel vendi, duke regjistruar pa pagesë pronën në emër të dy bashkëshortëve. Kjo masë afirmative ka ndihmuar në

rritjen e qasjes së grave në pronë dhe për herë të parë kemi arritur normën e pronësisë nga gratë në nivel vendi në përqindje prej 19,22 %”, ka njoftuar qeveria.

Ndahen 287 mijë euro për delegatët e legjislaturës së vitit 1990

Kabineti qeveritar ka ndarë 287 mijë euro për kompensim financiar të njëhershëm për delegatët e legjislaturës të vitit 1990. Këto mjete do të ndahen proporcionalisht për deputetët, të cilët kanë marrë pjesë në Mbledhjen e Kuvendit të Kosovës me datë 2 korrik 1990 dhe më 7 shtator 1990, si dhe kanë vazhduar të marrin pjesë në mbledhjet e Kuvendit deri më 24 maj 1992.

Po ashtu, qeveria ka ndarë 5.5 milionë për zbatimin e masës 2.2-Mbështetje e Bizneseve për qasje në financa, të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.

Në këtë mbledhje janë rialokuar mjetet buxhetore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal në përputhje me 14 marrëveshjet

e mirëkuptimit për projekte kapitale të nënshkruara nga ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, kryetarët e komunave dhe donatorët. Për këtë qëllim janë ndarë 3.5 milionë dhe do të shfrytëzohen për realizimin e 14 projekteve që janë të nënshkruara edhe në memorandumet e mirëkuptimit për projekte kapitale të nënshkruara në mes të ministrit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, kryetarëve të komunave dhe donatorëve.

Gjithashtu, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit i janë rialokuar 2.17 milionë euro për zbatimin e Programit “Masat preventive - intervenime emergjente nëpër komuna të ndryshme”.

Qeveria ka shkarkuar bordin menaxhues të Ndërmarrjes Publike “Trainkos Sh.A.” dhe është emëruar bordi i ri i përkohshëm deri në përzgjedhjen e bordit të ri. “Përbërja e bordit të ri të përkohshëm është: 1. Riza Spanca, kryesues. 2. Astrit Mehaj, anëtar. 3. Hasan Preteni, anëtar. Dhe 4. Shaban Neziri, anëtar”, ka njoftuar Qeveria e Kosovës.



Hovenier: ShBA-ja e shqetësuar për incidentin në Zveçan

PRISHTINË, 12 PRILL - Shtetet e Bashkuara janë shprehur të shqetësuara për incidentin në veri të Kosovës më 10 prill, në të cilin dyshohet të jetë plagosur një pjesëtar i komunitetit serb.

Policia e Kosovës ka thënë më 11 prill se i ka suspenduar katër zyrtarë policorë që dyshohet të jenë përfshirë në

këtë rast, përfshirë njërin që mund të ketë shtënë me armë zjarri. Kjo gjë e ka shqetësuar Ambasadën Amerikane në Prishtinë, e cila ka bërë thirrje të kryhen hetime kredibile. “Të gjithë shtetasit duhet të kenë besim në transparencën e zyrtarëve për zbatim të ligjit dhe në sektorin e drejtësisë. Mbështetja e Shteteve të

Bashkuara ndaj institucioneve për sundim të ligjit avancojnë një vizion të përbashkët të një shteti demokratik dhe multi-etnik”, ka thënë ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier. Sipas tij, “të gjithë personat përgjegjës për këto veprime kriminale duhet të mbajnë përgjegjësi”.





Drafti i ri i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme lehtëson votimin për diasporën

Javën e kaluar Komisioni Ad Hoc për reformë zgjedhore, i themeluar nga Kuvendi i Kosovës, ka përmbyllur punën, duke hartuar draftin e ri të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. E veçanta e tij ka të bëjë me votimin e mërgatës në zgjedhjet në Kosovë. Sipas këtij draftligji, në zgjedhjet e ardhshme parlamentare bashkatdhetarët do të evidentohen si votues në mënyrë elektronike, ndërkaq ambasadat dhe konsullatat e Kosovës gjatë zgjedhjeve do të shndërrohen në qendra të votimit. Kjo punë do t'u kursejë bashkatdhetarëve tanë buxhet dhe kohë dhe do të mundësojë që fletëvotimet të arrijnë shpejt e sigurt

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 12 PRILL - Javën e kaluar Komisioni Ad Hoc për Reformën Zgjedhore, i themeluar nga Kuvendi i Kosovës, ka përmbyllur punën, duke hartuar draftin e ri të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Ky draft së shpejti do të trajtohet edhe në qeveri për ta dhënë opinionin dhe komentet, pastaj në Kuvendin e Kosovës.

Të mërkurën në mbledhjen e qeverisë kryeministri Albin Kurti ka shpalosur një dimension të veçantë të tij e që ka të bëjë me votimin e mërgatës në zgjedhjet në Kosovë. Ai ka thënë se në esencë ky draftligji i jep fund një padrejtësie të gjatë ndaj mërgatës kur vjen puna te votimi dhe përmbush përfundimisht edhe një zotim të qeverisë ndaj mërgatës. "Ai

parashih që mërgata të ketë lehtësim real të shprehjes së vullnetit të tyre politik, teksa ambasadat dhe konsullatat e Republikës gjatë zgjedhjeve do të shndërrohen në qendra të votimit. Votuesit nga mërgata në të kaluarën përgjithësisht janë përballur me dy sfida. Së pari, regjistrimi i tyre ka përfshirë procedura të komplikuar e burokraci. Së dyti, afatet për dërgimin e fletëvotimeve me postë kanë qenë të shkurtra, krahas kostonë së lartë financiare", ka thënë Kurti.

Kryeministri ka thënë se, sipas këtij draftligji, në zgjedhjet e ardhshme parlamentare bashkatdhetarët do të evidentohen si votues në mënyrë elektronike. "Regjistrimi i tyre do të jetë shumë më i lehtë dhe do të bëhet online, ngjashëm si në shembullin e shërbimeve të cilat

kryhen sot në platformën e-Kosova. Ndërsa për hedhjen e fletëvotimeve ata do të kenë tri opsione. 'I pari do të jetë votimi fizikisht një ditë para ditës së zgjedhjeve në njërën nga ambasadat apo konsullatat e Republikës së Kosovës; Opsioni i dytë do të jetë dërgimi i fletëvotimeve me postë brenda vendit ku jetojnë, në adresën që e cakton Ambasada e Republikës së Kosovës. Me këtë ambasadat do të shndërrohen në qendra të grumbullimit të fletëvotimeve. Kjo do t'u kursejë bashkatdhetarëve tanë buxhet dhe kohë dhe do të mundësojë që fletëvotimet të arrijnë shpejt e sigurt; si dhe opsioni i tretë mbetet mënyra e vjetër e votimit, duke i dërguar fletëvotimet me postë në adresë të Komisionit Qendror Zgjedhor për vendet ku Kosova nuk ka ambasadë apo konsullatë ende", është shprehur Kurti.

Kurti ka thënë se mërgata jonë përbën rreth 1/3 të popullsisë së tërësishme të vendit, të cilët, të lidhur ngushtë me vendlindjen dhe me një kontribut të madh ekonomik e politik si në të kaluarën, ashtu edhe tani, meritojnë të jenë pjesë e vendimmarrjes në Kosovë. "Për shkak të barrierave dhe procedurave burokratike, interesimi i tyre për vendlindje ka qenë gjithmonë më i lartë sesa pjesëmarrja në procese zgjedhore. Me ndryshimet sipas draftligjit të ri, pjesëmarrja në zgjedhje do t'i përgjigjet interesimit dhe vullnetit

për të qenë pjesë e vendimmarrjes. Uroj që ky projektligji t'i kalojë së pari të gjitha procedurat e parapara deri në miratimin në Kuvend. Si Qeveri e Republikës së Kosovës përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës do t'i ndërmarrim të gjitha veprimet e nevojshme për ta përgatitur e përshtatur infrastrukturën në ambasadat e në konsullatat edhe për këtë shërbim ndaj bashkatdhetarëve tanë", ka deklaruar Kurti.

Kuvendi do t'i trajtojë e formalizojë së shpejti propozimet e reformës zgjedhore

Kryetari i Komisionit Ad Hoc i Kuvendit për Reformën Zgjedhore, Abelard Tahiri, ka bërë me dije se ky komision ka përmbyllur punën duke përfunduar të gjitha propozimet që do t'i shkojnë Kuvendit për miratim. "Pas një angazhimi sistematik për muaj me radhë, duke iu përgjigjur një klime të debatit tematik e gjithëpërfshirës rreth reformave, kemi ndërtuar një konsensus normativ që sistemin zgjedhor të Kosovës e avancojnë në një dimension të ri, duke iu përgjigjur kërkesës për transparencë, demokraci e besim, paralelisht me aderimin në standardet ndërkombëtare e demokratike bashkëkohore", ka thënë ai. Tahiri ka thënë se është shumë mirënjohës ndaj të gjitha grupeve

parlamentare për konstruktivitetin dhe kohezionin e plotë me të cilin iu kanë qasur reformave si rezultat i të cilit kanë arritur ta përmbyllin një proces vital për demokracinë në vendin tonë. "Shpresoj shumë që edhe Kuvendi do t'i trajtojë e formalizojë së shpejti propozimet e reformës zgjedhore si një hap drejt fuqizimit të demokracisë dhe rritjes së sigurisë e cilësisë së proceseve zgjedhore demokratike", ka thënë Tahiri.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka mirëpritur përmbylljen me sukses të propozimeve legjislativë për realizimin e kësaj reforme dhe i ka përgëzuar anëtarët e Komisionit Ad Hoc të Kuvendit për Reformën Zgjedhore, të kryesuar nga shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, për punën e madhe, kohezionin politik e përkushtimin përtej partiak për ta avancuar këtë segment vital të demokracisë.

Krasniqi ka thënë se për më shumë se një dekadë PDK-ja ka qenë e hapur dhe e angazhuar për ta reformuar sistemin zgjedhor në Kosovë me qëllim të avancimit strukturor dhe përmbajtjesor të proceseve elektorale si një parakusht për demokraci të qëndrueshme, pushtete të përgjegjshme dhe institucione të ligjshme. "Kjo reformë tashmë është në procedura parlamentare dhe së shpejti do të miratohet për t'i dhënë vullë përfundimisht vullnetit politik konsensual që e kemi arritur", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Mbi 400 migrantë kanë vdekur në Mesdhe gjatë këtij viti

Gjenevë, 12 prill - Më shumë se 400 emigrantë kanë vdekur në detin Mesdhe në fillim të vitit 2023, duke tentuar ta kalojnë Mesdheun qendror nga Afrika Veriore për në Evropë. Sipas një deklaratë të Kombeve të Bashkuara, ky është tremujori i parë me më së shumti raste të vdekjeve që gjashtë vjet. Organizata Ndërkombëtare për Migracion ka regjistruar 441

vdekje në muajt janar-mars për rrugën më vdekjeprurëse të migrimit në botë, ku është theksuar se numri i vdekjeve mund të jetë më i madh sesa është dokumentuar. Sipas raportit, rreth gjysma e këtyre viktimave lidheshin me operacionet e ngadalta të shpëtimit të udhëhequra nga shtetet dhe ose nuk kishte fare mision shpëtimi.

Sipas António Vitorino, drejtor i përgjithshëm i Organizatës Ndërkombëtare për Migracion, është e patolerueshme që krizat humanitare në Mesdheun qendror të vazhdojnë. “Unë shqetësohem për faktin se këto tragjedi janë bërë të zakonshme, pasi që nga viti 2014 më shumë se 20 000 viktima janë raportuar në këtë rrugë. Shtetet duhet të veprojnë”, tha ai.

Në kërkim të një jete më të mirë në Evropë, mijëra migrantë, kryesisht nga Afrika, nisen kryesisht me varka të vogla në udhëtime të rrezikshme nga brigjet e Libisë dhe Egjiptit. Krahasuar me rrugën nga Maroku për në Spanjë, kjo rrugë përmes Mesdheut qendror është më ndryshe. Shumë shpesh anijet fundosen, si në rastin e një anijeje në rajonin jugor italian të

Kalabrisë, që la të vdekur të paktën 72 migrantë në fund të shkurtit.

Pas një “rritjeje të madhe” të fluksit të emigrantëve nëpër Mesdhe, Qeveria e Italisë shpalli të martën gjendjen e jashtëzakonshme për imigracionin. Kjo është bërë për ta menaxhuar më mirë fluksin e migrantëve dhe për t’i lehtësuar procedurat për riatdhesim.



Shqipëria dhe Kosova lehtësojnë edhe më shumë lëvizjen e lirë



TIRANË, 12 PRILL - Ministri i Brendshëm i Shqipërisë, Bledi Çuçi dhe homologu i tij nga Kosova, Xhelal Sveçla, të mërkurën në Tiranë kanë nënshkruar protokollin që përmirëson më tej regjimin e lëvizjes së lirë ndërkufitare për banorët e zonave në të dyja anët e kufirit Shqipëri - Kosovë sipas marrëveshjes së firmosur vitin e shkuar. Ky protokoll është një hap tjetër përpara në këtë proces lehtësimi sepse, krahas lirisë së lëvizjes me këmbë, shtohet edhe kalimi me automjete për nevoja të jetës së përditshme të këtyre banorëve. Pas nënshkrimit të protokollit,


ministri Sveçla tha se puna e vazhdueshme e përbashkët po sjell rezultate. “Po kërkon përmirësim të vazhdueshëm të marrëveshjeve në mënyrë që ta lehtësojmë jetën e qytetarëve dhe të jemi në shërbim të tyre sa më shumë të jetë e mundur”, ka thënë Sveçla, duke shtuar se me nënshkrimin e këtij protokollit jo vetëm do t’i afrojnë institucionet, por edhe qytetarët e dy vendeve. “Po ashtu, jam i bindur se nuk do të jetë marrëveshja e fundit, por do të ketë një vazhdimësi marrëveshjeve të cilat i kemi nënshkruar dhe do të vazhdojmë t’i nënshkruajmë derisa të vijë koha që qytetari i dy vendeve të

mos dijë se ku ndodhet apo ku punon”, ka deklaruar Sveçla. Ministri Çuçi tha se do të dëshironte të kishte vetëm një marrëveshje, që të mos kishte kufi fare. “Kjo lëvizje e lirë që ne po u mundësojmë banorëve kufitarë brenda 30 km të secilit vend, të ishte për të gjithë territorin e Kosovës dhe Shqipërisë, por deri atëherë, meqë jetojmë në Evropë dhe jemi bashkësi e Evropës, duhet të respektojmë këto marrëveshje ndërkombëtare në të cilat jemi pjesë. Deri atëherë bëjmë të pamundurën që shtetasit tanë të qarkullojnë sa më lirshëm”, ka thënë Çuçi.

PSD-ja gjobitet me 20 mijë euro për aksionin me nënshkrimet

PRISHTINË, 12 PRILL - Me 20 mijë euro është gjobitur Partia Socialdemokrate nga Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) për "përpunim të kundërligjshëm të të dhënave personale". Kjo parti një muaj më parë përmes një aksioni simbolik pati vendosur para ndërtesës së Qeverisë së Kosovës 205 mijë nënshkrimet e peticionit të vitit 2016 kundër marrëveshjes për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Por, sipas kreut të PSD-së, Dardan Molliqaj, ky është dënim ndaj opozitës. "Dënimi është sulm ndaj opozitës. Agjencia për Informim dhe Privatësi ka dënuar PSD-në me 20 000 euro gjobë për, sipas tyre, publikimin e të dhënave të peticionit kundër Zajednicës. Në këtë vendim nuk kanë lejuar as ankesë. Madje kërcënojnë që pas 30 ditësh do të aktivizohen përmbaruesit. Nga informatat e brendshme del që presioni direkt ka ardhur nga Hekuran Murati.

Duhet të kujtojmë që në krye të këtij institucioni qëndrojnë njerëz që janë të lidhur ngushtë me pushtetin përmes lidhjeve edhe familjare. Ky dënim është i jashtëligjshëm, selektiv dhe politik", ka thënë Molliqaj. Ai ka theksuar se në aktivitetin e tyre nuk ka ndodhur kurrfarë publikimi e as keqpërdorimi i të dhënave. "Peticionet janë shpërndarë në oborr qeveritar, në prani të policisë, pa publikuar asnjë informacion të përveçëm. Prandaj ky dënim është i jashtëligjshëm. Në qershor të vitit 2022 të njëjtin peticion e kemi dërguar në hyrje të kryeministrisë, madje kemi publikuar edhe nënshkrimin e Albin Kurtit. Për këtë nuk kemi dënuar, sepse në atë kohë pushteti ende nuk e kishte pranuar Zajednicën 'de jure'. Tash që e ka pranuar themelimin e saj, vjen dënimi si tentim për ta shuar rezistencën. Prandaj ky dënim është selektiv", është shprehur



Molliqaj.

Ai ka shtuar se agjencia në fjalë ka zgjedhur dënimin me gjobë si masën më të ashpër, duke anashkaluar format e tjera të

masave që i parasheh ligji. "Prandaj ky veprim është politik. Dënimi me gjoba ekstreme është forma e re e sulmit ndaj opozitës. Pasi i kanë humbur argumentet,

po mundohen të na e pamundësojnë aktivitetin. Por e drejta është me ne, dhe vullnetin e kemi të madh", ka theksuar Molliqaj.

Lansohet sistemi për gjurmimin elektronik të lëndës në kadastrë

PRISHTINË, 12 PRILL - Që nga e mërkura qytetarët e Republikës së Kosovës do të mund ta gjurmojnë lëndën e dorëzuar në kadastrë nëpërmjet formës elektronike në uebfaqen e Agjencisë Kadastrale të Kosovës. "Ky sistem është i qasshëm për të gjithë qytetarët e Kosovës me një klik nga shtëpitë e tyre", thuhet në njoftimin për medie të Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Deri tani mënyra e vetme për informim për kërkesat e qytetarëve ishte nëpërmjet vizitës së drejtpërdrejtë në zyrën kadastrale komunale. "Pra, secila kërkesë drejtuar zyrove kadastrale komunale do të mund të gjurmohet nga aplikuesi në kohë reale. Mjafton që secili aplikues në momentin që dorëzon kërkesën në ZKK ta shënojë edhe numrin e telefonit dhe në momentin që kërkesa regjistrohet si kërkesë e re në Regjistrin e të drejtave pronësore, aplikuesi do të ketë



mundësi ta përcjellë statusin e lëndës së tij. Përmes sms-it do t'i përcillet numri referent i lëndës bashkë me linkun për kyçe në

sistemin për gjurmim. Duke klikuar në këtë link e duke shënuar numrin referent do të shfaqet statusi i lëndës së

dorëzuar në zyrën kadastrale komunale", thuhet në njoftim. Me këtë mundësi qytetari do të informohet për statusin e lëndës

në çdo kohë 24/7, pa pasur nevojë të shkojë në ZKK. Përveç statusit të lëndës, qytetarët do të mund të informohen edhe për arsyen e refuzimit eventual të kërkesës së tyre. "Pra bashkë me hapat e ndjekur nga kërkesa do të mund të kuptojnë edhe se cilat kushte nuk janë plotësuar për regjistrimin e të drejtës pronësore apo çfarëdo lloj lënde tjetër për të cilën kanë aplikuar. Ky zhvillim do t'u shërbejë edhe gjeodetëve të licencuar në punën e tyre të përditshme për lëndët të cilat i dorëzojnë në zyrat kadastrale komunale. Ky zhvillim nga Agjencia Kadastrale e Kosovës vjen në kuadër të reformave në këtë fushë. Insistimi për zhvillime e avancime të reja me qëllim digjitalizimin e procedurave dhe ofrimin e shërbimeve sa më të mira për qytetarët kanë sjellë këtë zhvillim të ri i cili nuk do të jetë i fundit në këtë vit", thuhet më tej në njoftimin për medie.

Senati i UP-së përjashton profesorin Bekim Bejta

PRISHTINË, 12 PRILL - Senati i Universitetit të Prishtinës ka vendosur për përjashtimin e profesorit Bekim Bejta nga procesi mësimor dhe nga të gjitha aktivitetet akademike në këtë universitet. Lajmin e ka bërë me dije Këshilli Studentor i Fakultetit të Filologjisë. "Profesori i Fakultetit të Filologjisë, Bekim Bejta, është përjashtuar nga procesi mësimor dhe nga të gjitha aktivitetet akademike në Universitetin e Prishtinës. Pas

reagimit të Këshillit Studentor në Fakultetin e Filologjisë, lidhur me shkeljet e vazhdueshme disiplinore të denoncuar nga studentet, Senati largon përkohësisht nga puna profesorin Bekim Bejta ku, sipas fakteve dhe denoncimeve, ai pritët të përjashtohet përfundimisht së shpejti". "Menaxhmenti i Fakultetit të Filologjisë dhe Këshilli i Profesorëve, që kanë qenë indiferentë ndaj shqetësimeve për gjuhën

kërcënuese e deri në kanosje fizike të profesorit Bejta ndaj studenteve dhe personelit, tani kanë rastin e fundit për reflektim. Për këtë do të përkujdesen përfaqësuesit e studentëve në krye me Këshillin Studentor, si garanci më e madhe dhe korrekte. Universiteti nuk është institucion për rehabilitim dhe integrim, as arenë e sporteve luftarakë!", është thënë në njoftimin e Këshillit Studentor të Fakultetit të Filologjisë.



Nisin hetimet për sulmin ndaj gazetarit Syla



PRISHTINË, 12 PRILL - Prokuroria Themelore në Prishtinë tha se ka nisur "hetimet intensive" për të sqaruar dhe identifikuar të dyshuarit që sulmuan gazetarin Valon Syla të hënën mbrëma.

Prokuroria tha se sulmi ndaj Sylës është cilësuar "lëndim i lehtë trupor".

Syla mbrëmjen e 11 prillit ka marrë trajtim mjekësor në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës pas lëndimeve në kokë. Ai thuhet se u sulmua nga tre persona. Sulmi raportohet se ka ndodhur pasi Syla ka dalë nga studio televizive dhe dyshohet se është përcjellë nga të dyshuarit deri në lagjen Bregu i Diellit në Prishtinë.

Policia e Kosovës, në raportin 24-orësh, tha se sulmi është

raportuar se ka ndodhur pas orës 22:00 në rrugën "Ilir Durmishi" në Prishtinë.

Policia tha se të dyshuarit ende mbeten të panjohur për autoritetet e rendit dhe se ata pas sulmit janë larguar nga vendi i ngjarjes me një veturë me targa vendore.

Ndërkaq, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) e ka dënuar sulmin fizik ndaj gazetarit Valon Syla, duke kërkuar arrestim të menjëhershëm të kryesve të këtij sulmi. "Ky sulm për Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës është krejtësisht i papranueshëm dhe përpjekje serioze për të penguar dhe minuar lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias në Kosovë", u tha në reagimin e AGK-së.

Sulmi ndaj Sylës është dënuar nga Qendra Evropiane për Liri të Shtypit dhe Medies. "Ne dënojmë fuqishëm sulmin fizik ndaj gazetarit Valon Syla nga të paktën tre persona, që e lanë atë të gjakosur dhe me lëndime në kokë. Ne u bëjmë thirrje autoriteteve kosovare që të kryejnë hetime të pavarura dhe profesionale dhe t'i sjellin kriminelët para drejtësisë", shkroi kjo qendër në "Twitter".

Në mbledhjen e qeverisë, të mbajtur më 12 prill, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, kërkoj nga autoritetet që autorët e këtij sulmi të dalin para drejtësisë. "Sulmi i mbrëmshëm ndaj gazetarit dhe opinionistit Valon Syla është i patolerueshëm dhe i papranueshëm. Mospajtimet në

bindje dhe qëndrime nuk mund dhe nuk duhet të jenë shkas për sulme fizike. Në një shoqëri demokratike, të cilën e prezantojmë dhe e promovojmë me krenari, nuk duhet të lejojmë që asnjëherë që frika nga fjala e lirë të peshojë më shumë sesa liria e fjalës", tha Kurti.

Sulmin ndaj Sylës e ka dënuar edhe kryeparlamentari i Kosovës, Glauk Konjufca, që e ka cilësuar si "shkelje të rëndë të lirisë së shtypit dhe të drejtave të njeriut", duke theksuar se akte të tilla nuk mund "të tolerohen kurrsesi në një shoqëri demokratike". "Ata [gazetarët] kanë të drejtën e garantuar me Kushtetutën dhe ligjet e vendit tonë për ta kryer detyrën e tyre profesionale pa frikë dhe pa

ndonjë censurë apo presion të jashtëm. Sulmi ndaj tyre është një krim i cili nuk përkon as me kulturën dhe as me traditën tonë shqiptare", ka shkruar Konjufca në "Facebook".

Gazetari Syla kishte qenë cak i një sulmi tjetër fizik në dhjetor të vitit 2020.

Në raportin për të drejtat e njeriut të Human Rights Watch për vitin 2022, u tha se në Kosovë u regjistruan 22 raste të sulmeve ndaj gazetarëve në Kosovë. Sipas HRW-së, në shumicën e rasteve gazetarët janë përballur me ngacmime, kërcënime dhe frikësime në platformat e medieve sociale. Në raport, po ashtu, u tha se hetimet penale për këto raste ishin të ngadalshme.

Kosova shpall 14 prillin Ditë të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale Gjatë Luftës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 PRILL - Qeveria e Kosovës e ka shpallur 14 prillin Ditë të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale Gjatë Luftës së fundit. Në mbledhjen e ekzekutivit të mbajtur të mërkurën, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se ky vendim është marrë në bashkërendim me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani. Ai ka thënë se shpallja e kësaj dite bëhet për ta "njohur dhimbjen dhe vuajtjen e grave e vajzave, por edhe të burrave e djemve të mbijetuar të dhunës seksuale gjatë luftës" së fundit në Kosovë më 1998-99.


Në një njoftim për medie Osmani ka thënë se ky vendim do t'i kontribuojë kujtesës kolektive. "Rikujtojmë se gjatë luftës së fundit në Kosovë rreth

20 000 persona kanë qenë viktimë të luftës seksuale. Jeta e të gjithë këtyre personave ndryshoi përgjithmonë. Pikërisht më 14 prill ndryshoi gjithmonë edhe jeta e Vasfije Krasniqit, e cila u rrëmbye me forcë dhe u dhunua nga forcat serbe. Ajo mori guximin ta ndajë të vërtetën me tërë botën. Përmes rrëfimit të saj ajo u shndërrua në zërin e të gjithë të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë", ka thënë Osmani në propozimin që i ka drejtuar ekzekutivit për këtë vendim.

Sipas të dhënave të paraqitura nga institucionet në Kosovë, gjatë luftës së fundit janë rreth 20 000 raste të dhunimeve seksuale nga pjesëtarët e forcave serbe. Që nga viti 2014, kur është miratuar legjislacioni, të mbijetuarit e dhunës seksuale në

Kosovë mund ta marrin statusin e viktimës së dhunës seksuale dhe të përfitojnë një pension prej 230 eurosh. Aplikimin ata e bëjnë përmes disa organizatave të përzgjedhura nga Qeveria e Kosovës. Por, ata duhet të kalojnë përmes disa procedurave për njohjen dhe verifikimin e statusit të tyre.

Për aplikim viktimë duhet të plotësojë një formular me të dhëna dhe detaje për vendin dhe periudhën kur ka ndodhur dhunimi, me deklarata nga dëshmitarët dhe me raporte eventuale mjekësore. Këto të dhëna paraqiten para një komisioni qeveritar, dhe nëse ky komisioni nuk bindet, viktimë duhet të dalë fizikisht para tij. Deri më tani mbi 1 000 persona u është njohur statusi i viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës.



Haradinaj: Qeverisë i kanë mbetur të pashfrytëzuara 478 milionë euro vetëm nga investimet kapitale



**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 12 PRILL - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka paraqitur disa shifra të shpenzimit të buxhetit për vitin e kaluar, të cilat, sipas tij, shpërfaqin mashttrimin e qeverisë. Përmes një shkrimi në "Facebook", Haradinaj ka thënë se janë të rralla rastet kur në kohë krize, ekonomike, sociale e shëndetësore, shtetit t'i teprojnë para, ose edhe të mos i mbledh as të hyrat e parapara për buxhetin e vet.

Sipas tij, për vitin 2022 qeveria ka paraparë t'i shpenzojë rreth 3 miliardë e 159 milionë euro, por i ka shpenzuar vetëm 2 miliardë e 625 milionë. "D.m.th i kanë tepruar hiç më pak se 533 milionë e 862 mijë euro, pjesa më e madhe prej të cilave në investimet kapitale. Me buxhetin e vitit 2022 për investime kapitale ishin paraparë 698 milionë euro e janë realizuar 422 milionë. D.m.th 280 milionë më pak. Për dy vjet kësaj qeverie i kanë mbetur të pashfrytëzuara 478

milionë euro vetëm nga investimet kapitale. Kjo d.m.th se është investuar më pak, është punuar më pak, është fituar më pak. Gjithçka më pak, vetëm se qytetari është varfëruar më shumë", ka shkruar Haradinaj.

Ai ka thënë se këto 478 milionë të taksapaguesve nuk u janë kthyer atyre, por janë ruajtur në "bunkerin financiar" të qeverisë dhe "kjo në kohën më të keqe jo vetëm për shkak të krizës ekonomike sociale, por edhe të inflacionit që ka mbërritur në pothuaj 20 për qind". "Për të qenë tabloja edhe më e zezë, prej këtyre 422 milionëve të investimeve kapitale, rreth 24 milionë janë pagesa ndëshkimore pa kurrfarë përfitimi, 88 milionë avanse për punë që as që kanë filluar, 16 milionë për mirëmbajtje, 17 për ndërtesa administrative e kështu me radhë... D.m.th rreth gjysma e kësaj shume (diku rreth 210 milionë) të investimeve kapitale janë sikur të mos kishin ndodhur fare sepse s'kanë pasur asnjë efekt në zhvillimin ekonomik", ka shkruar

Haradinaj.

I pari i AAK-së është shprehur se ka pasur propagandë të tmerrshme edhe në fushën e punësimit. "Njëri thoshte se janë punësuar mbi 20 mijë persona e tjetri ia kalonte... Por, faktet flasin ndryshe! Me Ligjin për Buxhetin 2022 janë paraparë që në sektorin publik mund të figuronin 87 mijë e 311 të punësuar, kurse për këtë vit kanë qenë 7 225 veta më pak nga sa lejonte buxheti. Kjo do të thotë se kjo qeveri nuk e ka realizuar planin e punësimit as aq sa ia lejonte buxheti i paraparë. Këta edhe fondin e pagave e kanë pasur për 8 milionë euro më pak se në vitin 2020. Por kjo është shuma nominale, sepse nëse asaj ia kalkulojmë rritjen e çmimeve dhe inflacionin për vitin 2021 dhe 2022, del se të punësuarit në sektorin publik për vitin 2022, në vlerë reale janë paguar përreth 100 milionë më pak", ka shkruar lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj.

Ai e ka kritikuar ekzekutivin duke thënë se, përveç që nuk ka shpenzuar aq sa e ka pasur buxhetin dhe aq sa ka paraparë,

ajo ka shënuar dështime edhe në grumbullimin e buxhetit. "Kështu p.sh, nga të hyrat e parapara buxhetore për vitin 2022, në shumën mbi 3 miliardë euro, janë realizuar 382 milionë më pak. Është e pakuptueshme sesi i ka dalë kjo matematikë qeverisë, sepse krahasuar me vitin paraprak, importet për vitin 2022 janë rritur për rreth një miliard, kurse eksportet përreth 165 milionë. Në total i bie që deficitit tregtar ka shënuar rritje për 790 milionë. Kjo i bie që janë vjel taksa më shumë, por buxheti ka mbetur mangët për 382 milionë. Kjo kërkon shpjegim!", ka shtuar ai.

Haradinaj ka thënë se në matematikat buxhetore financiare të qeverisë ka edhe një anomali tjetër. "Derisa mallrat që kanë hyrë në Kosovë kanë shënuar rritje për 20 për qind, të hyrat nga doganat janë rritur vetëm për 6.4 për qind, ose akciza për vetëm 3.2 për qind. Kjo d.m.th se ose ka rënë kontrolli doganor, ose është rritur kontrabanda në kufi dhe krimi i organizuar. Në këtë qeveri, po, ka pasur disa rritje",

ka theksuar ai.

Ai, gjithashtu, ka deklaruar se janë rritur shpenzimet në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, prej 280 milionë sa ka qenë në vitin 2021, në 333 milionë në vitin 2022. "Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit prej 3 milionë e 182 mijë eurosh sa kanë qenë në vitin 2020, janë rritur në 8 milionë e 185 mijë në vitin 2022. Janë rritur edhe udhëtimet brenda vendit, nga 1 milion e 73 mijë euro në vitin 2020, në 2 199 mijë; Karburantet për vetura zyrtare nga 6 milionë e 613 mijë në 2020 janë rritur në 11 milionë e 342 mijë euro në 2022. Edhe drekat zyrtare, po ashtu. Që të mos dalë se kjo qeveri ka pasur vetëm rënie. Ka pasur edhe rritje, në luksin e qeverisë, për të cilin na ka pasur folur aq shumë Albin Kurti! Dhe krejt këto që i paraqita më sipër janë nga të dhënat zyrtare të qeverisë, sepse e vërteta e plotë do të dalë vetëm pas raportit të Auditorit Gjeneral për buxhetin e vitit 2022 dhe ajo ka mundësi të dalë edhe më e hidhur", ka përfunduar Haradinaj.

Bursa shqiptare e energjisë (ALPEX), një hap më afër tregut të përbashkët energjetik Kosovë - Shqipëri

PRISHTINË, 12 PRILL - Në Tiranë është shënuar hapja e Tregut të Ditës në Avancë të Bursës Shqiptare të Energjisë, ALPEX, ku e pranishme ishte edhe ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, zëvendëskryeministria e Shqipërisë, Belinda Balluku, si dhe përfaqësues të tjerë të Republikës së Kosovës

dhe të Shqipërisë.

Rizvanolli ka theksuar se bursa shqiptare e energjisë (ALPEX) është një hap më afër tregut të përbashkët energjetik Kosovë - Shqipëri. Ajo ka thënë se tregu i përbashkët siguron mundësi të reja biznesi dhe më shumë tregti ndër-kufitare. "Në këtë mënyrë do të arrijmë përfitime

në efikasitet dhe standarde më të larta të shërbimit, e ALPEX e ka mbështetjen e plotë nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Bashkë jemi më të fortë, Shqipëri e Kosovë, bashkë me aleatët e me fqinjët tanë me të cilët ndajmë vlerat e qëllimet", ka thënë ministria Rizvanolli.



Dhjetë mistere antike ende të pazgjidhura



Historia e lashtë është e mbushur me mistere të pazgjidhura, disa prej të cilave, nga vend-varrimet tek qytetet e fundosura, kanë ndikuar shumë tek imagjinata e publikut për shekuj me radhë. Ja cilët janë 10 prej tyre:

1. Vijat Nazca

Afro 2000 vjet më parë, një qytetërim para-inkas gdhendi një sërë vizatimesh gjigante në rrafshnaltën e thatë të Perusë. Të njohur si Vijat Nazca, këto gjeoglif mbetën të panjohura derisa avionët filluan të fluturonin mbi zonë në vitet 1930. Deri më sot, janë zbuluar mbi 1000 modele. Shumica janë vija të drejta, që shtrihen deri në 48 km, ose forma gjeometrike, nga trapezoidët tek spirale. Ndërkohë të tjerat paraqesin kafshë dhe bimë, përfshirë një merimangë, një koliber, një majmun, një balenë, një gjarpër me dy koka, një qen dhe një figurë humanoide me nofkën "Astronauti". Në vitin 2022, u zbuluan 168 gjeoglif, por studiuesit nuk e kuptojnë ende qëllimin e tyre. Një hipotezë i lidh ato me ritualet e ujit, megjithëse ka shumë supozime.

2. Thonis-Heracleion

Një qytet port egjiptian në Detin Mesdhe, Thonis-Heracleion shërbeu si një qendër kryesore tregtare përpara themelimit të Aleksandrisë aty pranë rreth vitit 331 Para Erës Sonë. Heroi i mitologjisë Herakliu (Herkuli) dhe Helena e Trojës supozohet se kaluan disa kohë atje. Megjithatë, rreth shekullit II Para Krishtit, qendra e qytetit u shemb për shkak të lëngëzimit të tokës, ndoshta e shkaktuar nga tërmetet, tsunami ose përmblytjet.

Në fund i gjithë Thonis-Heracleion u fundos nën ujë, ku mbeti i humbur derisa u ri-zbulua në fillim të viteve 2000 nga arkeologët detarë. Statuja të mëdha, sarkofagë kafshësh, rrënoja tempujsh, copat e qeramikës, bizhu, monedhat, madje edhe shporta me fruta 2400-vjeçare janë nxjerrë nga dallgët, duke hedhur kështu një dritë të re mbi këtë Atlantidë reale.

3. Rrafshnalta e Kavanozëve

Mijëra kavanoza prej guri të Epokës së Hekurit, disa afro 3 metra të lartë dhe që peshojnë disa ton, mbulojnë peizazhin malor të Laosit verior. Të gdhendura kryesisht nga gurë ranorë dhe të gjetur në grupe që variojnë nga vetëm 1 deri në 400, legjenda thotë se gjigantët i përdornin ato si gota vere. Por shumë arkeologë besojnë se ato shërbyen si krematoriume për djegien e trupave të të vdekurve. Por ka ende shumë gjëra të panjohura për qëllimin e tyre, mbi mënyrën se si u zhvendosën deri atje dhe për qytetërimin që i prodhoi ato. Studimet e fundit kanë zbuluar se disa prej kavanozëve prej guri datojnë që në vitin 1240 Para Krishtit, pra shumë më të vjetra se skeletet njerëzore të varrosura aty pranë. Problemi është se shumë prej kavanozëve gjenden në fushat e municioneve të pashpërthyera, mbetjet Luftës së Vietnamit, ndaj nuk mund të studiohen në mënyrë të sigurt.

4. Gjiri Guanabara

Duke vepruar sipas një informacioni të marrë nga vendasit, eksploruesi i anijeve të

mbytura, Robert Marx, pretendoi në vitin 1982 se kishte zbuluar një numër vazosh romake me dy doreza, të njohura si amfora, në Gjirin Guanabara të Brazilit. Sipas tij, amforat siguruan prova se romakët ishin evropianët e parë që zbarkuar në Brazil, ose 1 mijë vite më herët se portugezët. Megjithatë, ai nuk ishte në gjendje ta eksploronte plotësisht vendin, pasi qeveria braziliane e ndaloi për shkak të një plaçkitje të dyshuar të sitit. Marx akuzoi Marinën e Brazilit për hedhjen e sedimenteve mbi amfora në mënyrë që të pengohej rishkrimi i historisë. Deri më sot, një prani romake në brigjet e Brazilit mbetet ende e paprovuar.

5. Paracas Candelabra

Në veriperëndim të Vijave Nazca, të gdhendura në një kodër me pamje nga Gjiri Pisko në Peru, shtrihet Candelabra Paracas, një tjetër gjeoglif masiv me një shtrirje prej rreth 183 metrash nga lart poshtë. Ndonëse qeramika e gjetur në vend daton rreth vitit 200 Para Krishtit, askush nuk e di moshën e vetë figurës në formën e një shandani. Edhe arsyeja e saj e ekzistencës mbetet po aq e paqartë. Një teori thotë se ai shërbeu si një mjet orientimi për marinarët, ndërsa një tjetër pretendon se përshkruante treshen e Zotit krijues.

6. Sacsayhuamán

Diku tjetër në Peru, në periferi të Cuzco, ndodhen mbetjet e kështjellës Sacsayhuamán, e cila u ndërtua me kujdes nga inkasit në vitet 1400. Ashtu si në Machu Pichu, punëtorët inkas lëvizën gurë të mëdhenj – disa prej të cilëve peshonin 125 tonë ose më shumë – përpara se muratorët t'i

prisnin në copa më të vogla, duke përdorur vetëm vegla bronzi dhe guri dhe t'i vendosnin mbi njëri-tjetrin pa llaç. Ndonëse kolonizatorët spanjollë çmontuan pjesën më të madhe të kështjellës për t'i përdorur si materiale ndërtimi, Sacsayhuamán ka mbetur strukturalisht e fortë për t'i bërë ballë tërmeteve të mëdha dhe shkatërrimeve të tjera të kohës.

7. Varri i Kleopatrës

Si një sundimtare e lashtë, për Kleopatrën VII, ose të ashtuquajturën mbretëresha e fundit e Egjiptit, dihet shumë. Ajo u bashkua me Jul Çezarin dhe Mark Antonin dhe më vonë kreu vetëvrasje në vitin 30 Para Erës Sonë pas humbjes së Antonit dhe të saj në Betejën e Aktiumit përballë Oktavianit. Por vendndodhja e Antonit dhe varrit të saj – supozohet se çifti u varros së bashku – mbetet një mister. Disa studiues besojnë se ai ndodhej në Aleksandri, kryeqyteti i saj dhe qendra dikur kulturore e botës mesdhetare, dhe humbi kur një tsunami përmblyti qytetin në vitin 365 Pas Krishtit. Të tjerë dyshojnë se ndodhet diku tjetër në deltën e Nilit, ndoshta në një tempull kushtuar Isis dhe Osiris, perënditë me të cilat u lidhën përkatësisht Kleopatra dhe Antoni.

8. Dorëshkrimi i Voynich

Në vitin 1912, tregtari i librave të rrallë, Wilfrid Voynich, shtiu në dorë një dorëshkrim mesjetar që ai pretendonte se ishte vendosur në "një kështjellë të lashtë në Evropën Jugore". E shkruar në një gjuhë ose kod të zhdukur, askush nuk mund ta njohte origjinën. Ai ishte mbushur me ilustrime të

çuditshme të bimëve fiktive dhe grave të zhveshura. Kriptografi britanik Alan Turing dhe FBI-ja amerikane u përpoqën ta zgjidhnin misterin por dështuan. Disa dyshojnë se ky dorëshkrim është një mashtrim i sofistikuar. Dorëshkrimi i Voynich ndodhet sot në Universitetin e Yale, i disponueshëm për publikun dhe cilindo që është i interesuar të përpiqet ta zgjidhë një herë e përgjithmonë këtë enigmë.

9. Monumenti Yonaguni

Në brigjet e ishullit Yonaguni të Japonisë shtrihet një strukturë shkëmbore nënujore, të paktën 50 metra e gjatë dhe 20 metra gjerë, që i ngjan një piramide të ndërtuar nga njeriu. I zbuluar në vitet 1980 dhe i njohur tani si Monumenti Yonaguni, disa studiues besojnë se ato janë rrënojat e një qytetërimi të lashtë. Megjithatë, shumë studiues të tjerë pretendojnë se "Atlantida e Japonisë" nuk është gjë tjetër veçse një fenomen natyror i formuar nga ngritja tektonike dhe rrymat e oqeanit.

10. Stonehenge

Stonehenge, një nga monumentet prehistorike më të famshme në botë, filloi rreth 5000 vjet më parë, përpara se Anglia të hynte në Epokën e Bronzit. I studiuar mirë për shekuj me radhë, shumica e studiuesve e pranojnë se funksiononte si një vend varrimi, dhe tani dihet se nga erdhën gurët e mëdhenj. Megjithatë, sekretet e tjera të Stonehenge mbeten mister, përfshirë rëndësinë e tij të mundshme fetare, ceremoniale, astronomike dhe terapeutike. / history.com – bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enverti
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Duka, mesazh Kombëtares: Në qershor duam 6 pikë

TIRANË, 12 PRILL - Pasi nisi fushatën eliminatorë me humbje në Poloni, Kombëtarja Shqiptare do të rikthehet në fushë në qershor për t'i luajtur dy sfida të tjera, ndaj Moldavisë dhe Ishujve Faroe. Në letër janë dy takimet më të lehta të

kuqezinjve, megjithatë në intervistën për "SuperSport", presidenti i FShF-së, Armand Duka, bën apelin që futbollistët dhe stafi t'i vlerësojnë maksimalisht, duke i quajtur këto takime si vendimtare për rrugëtimin drejt Gjermani 2024.

"Atmosfera është pozitive, por ne duhet t'i kënaqim tifozët dhe të marrim dy fitore në qershor. Janë dy ndeshje të lehta në letër, por jo të tilla në fushë. Duhet t'i vlerësojmë maksimalisht, pasi e kam thënë gjithmonë, që në Gjermani do të shkojnë

skuadrat që do t'i marrin të gjitha pikët ndaj Moldavisë dhe Ishujve Faroe. Duhet ta bëjmë maksimumin dhe t'i marrim pikët e plota, pasi kështu jam i bindur që do të kemi shanse maksimale të luajmë në Evropian", ka deklaruar kreu i FShF-së.



Reali triumfon ndaj Chelseat, fiton edhe Milani

MADRID, 12 MARS - Real Madridi ka shënuar fitore në ndeshjen e parë çerekfinale ndaj Chelseat. "Los Blancos" triumfuan me rezultat të pastër 2:0 në "Santiago Bernabeu". Ishte Karim Benzema që kaloi vendasit në epërsi në minutën e 22-të të ndeshjes, pas asistimit nga Vinicius Junior. Gjithçka u bë shumë herë më e vështirë për Chelsean kur Ben Chilwell u ndëshkua direkt me karton të kuq në minutën e 59-të. I inkuadruar në lojë vetëm tre minuta më parë, Marco Asensio realizoi për 2:0 në minutën e 74-

të të ndeshjes. Tani, Real Madridi do ta presë ndeshjen e kthimit më e qetë pasi që ka një avantazh të dukshëm nga ndeshja e parë. "Djajtë" e Milan kanë arritur të triumfojnë në "San Siro" ndaj "bluve" të Napolit, në "aktin e parë", të çerek-finaleve të UEFA Champions League, me rezultatin minimal 1 me 0, në një sfidë që prodhoi spektakël e emocione. Djemtë e Piolit e nisën keq pjesën e parë, me napoletanët të cilët u hodhën menjëherë në sulm, por një super Mike Maignan i mohoi 3



herë golin "bluve" dhe kaq u desh, që "djajtë" të ndiznin "motorët" dhe në minutën e 41-të falë një kombinimi fantastik të treshes Brahim Diaz-Rafael Leao-Ismail Bennacer, ky i fundit tund rrejtën e portierit Meret. Mirëpo, goli nuk ishte e vetmja "fitore" për "djajtë" e Milanos, teksa në minutën e 75-të një ndër "shtyllat" e mesfushës napoletane, kamerunasi, Zambo Anguissa u

detyrua të lërë më herët fushën e lojës, pas daljes me kartonin e kuq, të dhënë nga arbitri pas 2 ndërhyrjeve të gabuara të mesfushorit fillimisht në minutën e 71-të e më pas të në të 75-tën, por në sfidën tjetër nuk do të mungojë vetëm Anguissa, pasi vetëm 4 minuta pas daljes së kamerunasit, me karton të verdhë u ndëshkua dhe "kollosi" i mbrojtjes së "bluve", Kim Min-Jae, i cili do të

mungojë në ndeshjen e kthimit. Kështu, mungesat kryesore të "bluve" shkojnë në 4, ku në total do të mungojnë Zambo Anguissa, Kim Min-Jae, Victor Osimhen e Giovanni Simeone, me këta të fundit, që kanë ende kohë të rikuperohen për ndeshjen e kthimit në arenën "Diego Armando Maradona", ndeshje që do të zhvillohet mbrëmjen e 18 prillit në orën 21:00.

Boksierët e Kosovës në përgatitje të përbashkëta



PRISHTINË, 12 PRILL - Selektori i Përfaqësueses së Kosovës në Boks, Besim Brahimi, do t'i grumbullojë boksierët e përfaqësueses në përgatitjet e përbashkëta në Prishtinë nga 13 prilli. Federata e Boksit e Kosovës vazhdon sipas planprogramit të paraparë për përgatitje të boksierëve të Kosovës para garave ndërkombëtare. "Këto përgatitje janë të mirëseardhura për boksierët seniorë para

garave ndërkombëtare që i presin në muajt në vijim: Kampionati Botëror në Tashkent (Uzbekistan) 1-14 maj. Turneun Ndërkombëtar në Çeki, Hungari, Shkodër, Hungari dhe Kroaci", thuhet në njoftimin e Federatës së Boksit të Kosovës. Selektori, pas këtyre përgatitjeve, do të vazhdojë përgatitjet speciale me boksierët që do ta përfaqësojnë Kosovën në Kampionatin

Botëror. Së bashku me selektorin Besim Brahimi në këto përgatitje do të jenë dhe trajnerët Mehmet Haxhani, Lirim Shllaku dhe disa trajnerë të Kosovës që do të ndihmojnë në këto përgatitje. Selektori ka përzgjedhur këta boksierë: Bashkim Bajoku, Gentrit Gashi, Shpëtim Bajoku, Loris Idrizi, Patriot Behrami, Ardit Leka, Altin Shala, Taulant Jakupi, Remzo Mustafiq, Shpejtim Shabani dhe Donat Sylja.

Asani: Për Kombëtaren e Shqipërisë jap shpirtin

TIRANË, 12 PRILL - Jasir Asani fitoi zemrat e tifozëve shqiptarë me debutimin te Kombëtarja e Shqipërisë në ndeshjen kundër Polonisë. Ishte një prej më të mirëve të takimit që dalluan nga të tjerët te kuqezinjët. Në një

intervistë të fundit për "Kleagueunited" në Korenë e Jugut, Asani ka treguar arsyen se pse nuk zgjodhi Maqedoninë e Veriut përpara Shqipërisë. "Kam marrë ftesën e Kombëtares vetëm pesë ditë para

grumbullimit të tyre. Gjithmonë kam qenë në pritje për Kombëtaren dhe ishte ndjenja më e mirë. Do të jap gjithçka, shpirtin për Kombëtaren, gjithmonë", ka thënë Asani. "Unë kam luajtur për Maqedoninë e

Veriut, kam lindur atje dhe familja jeton atje, por ne jemi shqiptarë të Maqedonisë. Gjithmonë kam ëndërruar të luaj për Shqipërinë sepse jam shqiptar dhe jam shumë i lumtur që debutova me këtë fanellë", ka shtuar Asani.



Barcelona 'blindon' Xavin

BARCELONË, 12 PRILL - Barcelona i ka ofruar një kontratë të re dyvjeçare trajnerit Xavi Hernandez. Xavi ka filluar ta rikthejë Barçën në binarë dhe drejtuesit duan ta vazhdojnë bashkëpunimin.

Sipas gazetës "Marca", ka pasur komunikim në mes të dyja palëve të martën pasi drejtuesit e Barcelonës dhe agjenti i Xavit diskutuan kushtet e kontratës. Marrëveshja aktuale e Xavit

zgjat deri në qershor 2024, ndërsa synimi i klubit të tij është ta zgjasë atë deri në vitin 2026. Barça aktualisht është 13 pikë më shumë në krye të tabelës së La Ligas. Ata, gjithashtu, fituan

Superkupën e Spanjës në fillim të këtij sezoni. Agjenti i Xavit u pa dje me nënpresidentin e Barcelonës, Rafa Yuste dhe drejtuesit Mateu Alemany dhe Jordi Cruyff në "Nou Camp".



Lewandowski: Pas Botërorit kam një rënie, uroj të luaj me Messin

BARCELONË, 12 PRILL - Sulmuesi i Barcelonës, Robert Lewandowski, ka qenë i ftuar në një eveniment të organizuar nga klubi katalanas. Gjatë diskutimeve me mediet, sulmuesi polak i Barcelonës ka pranuar rënien e formës së tij, veçanërisht pas Kampionatit Botëror në Katar. Ndër të tjera, Leva është ndalur dhe te Lionel Messi dhe diskutimet e shumta në Barcelonë këto kohë në lidhje me rikthimin e mundshëm të "pleshtit" në "Camp Nou". "Mendoj se pas Kampionatit Botëror kam pësuar një rënie të formës, por ndikimi i Kampionatit Botëror nuk ka qenë vetëm për mua. Pothuajse të gjithë lojtarët e angazhuar në Katar kanë shfaqur probleme. Unë e ndiej shumë, pasi nuk jam mësuar të mos shënoj në dy ndeshje radhazi. Po punoj për t'u kthyer sërish në formë për pjesën e mbetur të sezonit", ka thënë Lewandowski. Sulmuesi polak ka folur edhe për titullin kampion me 13 pikë avantazh ndaj Realit. "Kemi tri vjet që nuk e fitojmë titullin kampion,



ndaj të gjithë tifozët tanë e presin që t'ia arrijmë këtë vit. Besoj se kemi një avantazh të konsiderueshëm dhe gjithçka është në duart tona. Nëse fitojmë titullin do të ishte shumë i rëndësishëm për të rinjtë veçanërisht, sepse do t'i mbushte me vetëbesim", ka shtuar ai. Sulmuesi i Barcelonës ka qenë i qartë dhe ka hapur dyert për Leo Messin që të kthehet në "Camp Nou". "Unë tashmë i jam

përgjigjur kësaj pyetjeje, por për mua Mesi do të jetë gjithmonë pjesë e Barçës. Nëse ai kthehet, jo vetëm për tifozët, por edhe për lojtarët, do të ishte mbresëlënëse. Vendi i tij është këtu, në Barcelonë. Nuk e di se çfarë do të ndodhë, nuk jam unë personi që të jap një përgjigje të saktë, por shpresoj që sezonin e ardhshëm të luajmë së bashku. Ne kemi nevojë për këtë lloj lojtari", ka thënë Lewandowski.

Lakersat triumfojnë në kohën shtesë dhe kalojnë në 'play-off'

Los Anxhelos, 12 prill - NBA ka nisur ndeshjet e fazës "play-in", në të cilën luajnë skuadrat e renditura në vendet 7-10 në të dyja konferencat. Të parat kanë zbritur në fushë skuadrat e klasifikuara në vendet 7-8. Nuk kanë munguar surprizat. Në Perëndim, Los Angeles Lakers fitoi 108-102 ndaj Minnesotas, ndeshje e vendosur pas kohës shtesë. LeBron Jamesi me 30 pikë e 10 rebounde ishte më i miri për kalifornianët, mbështetur nga Davisi me 24 pikë e 15 rebounde, si dhe Schroderi me 21 pikë. Vendimtar ishte stoli nga erdhën 40 pikë. Lakersi kualifikohet direkt për në çerekfinale, ku do të luajë ndaj Memphis Grizzliesit. Ndërsa Minnesota ka edhe një ndeshje shtesë me skuadrën që do të dalë fituese nga ndeshja tjetër "play in" në Perëndim mes New Orleansit e Oklahoma City Thunderit. Në Lindje, Atlanta Hawksi fitoi 116-105 jashtë fushës



ndaj Miami Heat, duke siguruar kështu çerekfinalin, ku do të luajë ndaj Boston Celticsit. Në ndeshjen dominuan miqtë, ku 7 lojtarë realizuan mbi 10 pikë. Young ishte më i miri me 25 pikë. Stoli i Atlantias

realizoi 51 pikë, duke i bërë të pavlefshme 33 pikët e Lowry për Miamin. Ekipi nga Florida do të ketë edhe një shans tjetër, teksa do të ndeshet me fituesin e çiftit Toronto - Chicago.

SHKURT

Guardiola: Rezultat i jashtëzakonshëm, por na duhet edhe një ndeshje e madhe

Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, e ka shijuar në maksimum fitoren me rezultat të thellë 3-0 përballë Bayern Munchenit, por nuk feston, i vetëdijshëm se në Munchen kërkohet një tjetër ndeshje e madhe. "Për 55-60 minuta ishte një ndeshje shumë e ekuilibruar, një ndeshje e bukur në Ligën e Kampionëve mes dy ekipeve të mëdha. Nuk arritëm t'i kontrollonim mirë fazat pas golit të Rodrit, i lejuam shumë hapësira. Ata ishin superiorë në 10-15 minutat e para, kishin disa raste. Është një rezultat i jashtëzakonshëm, por e di se çfarë do të thotë të luash në Munchen. Duhet një tjetër ndeshje e madhe", u shpreh Guardiola.

Tuchel: Rezultati nuk është shumë i drejtë

Aventura e Thomas Tuchelit nuk po shkon si duhet në krye të Bayern Munchenit, për më tepër që kjo ishte humbja e parë e ekipit gjerman në këtë edicion të Ligës së Kampionëve. Tuchel ka thënë se rezultati 3-0 nuk është edhe shumë i drejtë, pasi ekipi i tij u ndëshkua pikërisht në momentet kur po luante më mirë se City. "Rezultati nuk është shumë i drejtë, u ndëshkuam pikërisht atëherë kur po luanim më mirë se Manchester City. Pavarësisht se humbëm 3-0, refuzoj të flas për një paraqitje negative. Pashë një ekip të madh deri në minutën 70. Na mungojnë pak forca dhe besimi. Gjithsesi ky është një rezultat i vështirë për t'u përthypur, por në futboll asgjë nuk vjen rastësisht", ka deklaruar Tuchel.

Schmidt: Mund ta mposhtim Interin në Itali

Trajneri i Benficas, Roger Schmidt, e ka komentuar humbjen që pësoi skuadra e tij nga Interi në Ligën e Kampionëve (0-2). Ai ka thënë se skuadra portugeze në ndeshjen e kthimit në Itali shkon për fitore. "Një ndeshje e vështirë për të dy. Ne dhamë gjithçka dhe krijuam shumë shanse. Mund të kishim fituar ose minimalisht një barazim por, përkundrazi, humbëm me Interin që krijoi pak dhe shënoi dy gola. Sigurisht që nuk është mirë në ndeshjen e kthimit pasi kemi dy gola më pak, por ne mund të shkojmë në Itali dhe të fitojmë. Nuk jemi të demoralizuar", ka thënë Schmidt.

Al-Nassr shkarkon trajnerin Garcia

Rudi Garcia nuk është më trajner i Al-Nassrit. Mediumi spanjoll "Marca" raporton se klubi nga Arabia Saudite ka vendosur ta shkarkojë trajnerin francez. Bisedat e tij sekrete në dhomat e zhveshjes duket se e kanë çuar kryesinë e klubit që ta marrë këtë vendim. Garcia është akuzuar për taktikë të dobëta dhe për raportin e zbehtë me Cristiano Ronaldon. Ish-trajneri i Romës e kishte marrë në dorë ekipin arab në qershor të vitit të kaluar. Duket se Ronaldo e kishte një takim me drejtuesit e klubit dhe aty portugezi ka shprehur pakënaqësinë ndaj trajnerit, mbi të gjitha pas barazimit pa gola, 0-0, me Al Feiha. Al-Nassr gjendet tri pikë prapa liderit, Al Hilalit, shtatë xhiro pa përfunduar sezoni në Arabinë Saudite.

Inzaghi: Asgjë s'ka përfunduar

Skuadra e Interit e mposhti në Libsonë Benficën me rezultatin 2-0. Pas ndeshjes trajneri Simone Inzaghi është shprehur i kënaqur me paraqitjet e

futbollistëve që i drejton, derisa ka thënë se ende asgjë nuk ka përfunduar. "Kundër një ekipi të fortë dhe në një stadium të nxehtë, djemtë luajtën një

ndeshje të shkëlqyer. Ne fituam raundin e parë dhe është një kënaqësi e madhe, por asgjë nuk është mbyllur ende. Në ndeshjet e fundit nuk kishim

fituar, por ishte shfaqur performancë e mirë në fushë. Jemi në një moment shumë të vështirë, por duhet të shkojmë më tej dhe sonte po e shijojmë

këtë mbrëmje. Unë isha shumë shpresëdhënës sepse në ndeshjet e fundit kishim luajtur dhe krijuam shumë, përtej rezultatit", ka thënë Inzaghi.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 01/2023); lidhur me nenin 29 të Rregullores (ZKA) 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2023 si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme Nr. 444 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. Pozita:	Zyrtar i lartë ligjor
Numri i referencës:	ZLL/ZKA/02-04/23
Grada:	ZKA-B6
Numri i pozitave:	Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kontribuon për funksionim efikas dhe efektiv të departamentit në pajtim me objektivat individuale;
- Siguron ofrimin e këshillave profesionale, interpretimeve dhe mendime juridike për personelin e ZKA-së;
- Përgatitë rekomandime, opinione dhe interpretime ligjore për çështje të auditimit dhe çështje tjera nga mandati i ZKA-së;
- Propozon dhe merr pjesë hartimin e akteve juridike të ZKA-së, duke u kujdesur për përputhshmërinë e tyre me legjislacionin në fuqi;
- Hulumton dhe analizon legjislacionin lidhur me mandatin ligjor të ZKA;
- Përcjellë ndryshimet dhe plotësimet e reja ligjore dhe informon personelin lidhur me to;
- Harton parashtrësia dhe përfaqëson ZKA-në në procedura gjyqësore, ndërmjetësime dhe arbitrazh;
- Përcjellë praktikat legjislative ndërkombëtare lidhur me Institucionet Supreme të Auditimit;
- Analizon projekt aktet normative që janë në procedura konsultative dhe përgatitë komente lidhur me to, sipas rastit;
- Sipas autorizimit, merr pjesë në takimet punuese dhe dëgjimet publike në komisionet parlamentare, për diskutimin e çështjeve që ndërlidhen me mandatin e ZKA-së apo shqyrtimin e projektligjeve që janë në procedurë parlamentare;
- Kryen detyra tjera të ngarkuara nga Drejtori i departamentit.

Kualifikimet Themelore:

- Diplomë fakulteti në shkencat juridike;
- Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale, preferohet përvojë të punës hulumtuese dhe analitike;
- Preferohet provimi i jurisprudencës.

Shkathësitë e kërkuara:

- Njohuri dhe përvojë në hartimin, harmonizimin e legjislacionit dhe akteve tjera juridike;
- Njohuri të akteve juridike të aplikueshme në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Shkathësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit).

Informata të përgjithshme për kandidatë:

Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **28.04.2023 ora 16.00**.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollëshme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa članom 15.2 Zakona 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalne Kancelarije Revizije Republike Kosova, kao i Člana 5, 6 i 7 Uredbe (NKR) 03/2021 o prijemu i Karijeru u Nacionalnoj Kancelariji Revizije (izmenjeno i dopunjeno u Pravilniku (ZKA) Br. 01/2023); vezano sa Članom 29 Pravilnika (NKR) 02/2021 o Klasifikaciji radnih mesta, Godišnjem planu za regrutaciju za 2023. godine, kao i Odlukom Generalne revizorke br. 444, o popunjavanju slobodnih radnih mesta, Nacionalna Kancelarija Revizije objavljuje:

KONKURS za popunjavanje slobodnih radnih mesta

1. Pozicija:	Visoki pravni službenik
Referentni broj :	ZLL/ZKA/02-04/23
Rang:	ZKA-B6
Broj pozicija:	Jedna (1)
Trajanje imenovanja:	Na neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti:

- Doprinosi efikasnom i efektivnom radu odeljenja u skladu sa pojedinačnim ciljevima;
- Obezbeđuje davanje stručnih saveta, tumačenja i pravnih mišljenja za osoblje NKR-a;
- Priprema preporuke, mišljenja i pravna tumačenja za pitanja revizije i druga pitanja iz mandata NKR-a;
- Predlaže i učestvuje u izradi pravnih akata NKR-a, vodeći računa o njihovoj usklađenosti sa važećim zakonodavstvom;
- Istražuje i analizira zakonodavstvo u vezi sa zakonskim mandatom NKR-a;
- Prati promene i nove zakonske dopune i o njima obaveštava zaposlene;
- Piše izlaganja i zastupa NKR u sudskim postupcima, posredovanju i arbitraži;
- Prati međunarodnu zakonodavnu praksu u vezi sa vrhovnim revizorskim institucijama;
- Analizira nacрте normativnih akata koji su u konsultativnim procedurama i priprema komentare vezano sa njima, po slučaju;
- Prema ovlašćenju učestvuje na radnim sastancima i javnim raspravama u skupštinskim komisijama, radi razmatranja pitanja koja se vežu sa mandatom NKR-a ili razmatranja nacрта zakona koji su u skupštinskoj proceduri;
- Obavlja i druge poslove po nalogu direktora odeljenja.

Osnovne kvalifikacije:

- Fakultetska diploma pravnih nauka;
- Poželjno je sedam (7) godina profesionalnog radnog iskustva, istraživačkog i analitičkog radnog iskustva;
- Pravosudni ispit je poželjan.

Potrebne veštine:

- Znanje i iskustvo u izradi, usaglašavanju zakonskih i drugih pravnih akata;
- Poznavanje pravnih akata koji se sprovode u Nacionalnoj kancelariji revizije;
- Veština komunikacije i planiranja rada;
- Istraživačke, analitičke, evaluacione veštine i formulisanje preporuka i stručnih saveta;
- Sposobnost ispunjavanja zadataka i rada pod pritiskom;
- Poznavanje rada na računaru softverskih aplikacija (Word, Excel, Power Point, Access, Internet

Opšte informacije za kandidate:

Određivanje plate vrši se u skladu sa važećim zakonima.

Procedura aplikacije:

Procedura aplikacije je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna kancelarija revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve državljane Kosova i pozdravlja kandidate iz svih zajednica na Kosovu.

Kandidati trebaju predati sledeća potrebna dokumenta:

- službeni formular NKR-a za aplikaciju;
- kopiju lične karte Republike Kosovo;
- dokaz o školskoj spremi (fakultetska diploma). Diplome dobijene van Kosova moraju biti overene kod notara;
- dokaz o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Dokaz o radnom odnosu, uz dokaz iz Penzionog fonda);
- svedočenje iz suda da nije pravosnažno osuđivan (ne starije od šest meseci)
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog funkcionera (ako je primenljiva);


Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Dokumenta dostavljena nakon isteka roka se ne razmatraju a nepotpuna će biti odbijena. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja na elektronskim medijama (onlajn) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije. Zadnji rok za podnošenje dokumentacije **28.04.2023 godine do 16.00 časova**.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

Beleška:

Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručenju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.



Nr. prot.: 51/23

Datë: 12.04.2023

Mbështetur në Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.02/2016 për aktivitetet jashtë shkollore, Gjimnazi "Hamdi Berisha" në Malishevë shpallë:

OFERTË PËR EKSKURSION

Gjimnazi "Hamdi Berisha" në Malishevë shpallë ftesë për ofertë për zgjedhjen e agjencionit të udhëtimit për organizimin e Shëtitjes (Ekskursionit) në Republikën e Shqipërisë me maturantë për vitin shkollor 2022/2023.

Kohëzgjatja e shëtitjes (ekskursionit) do të jetë 4 bujtje / 5 ditë, me pansion të plotë.

Në ekskursion do të marrin pjesë 363 nxënës.

Agjencioni duhet të plotësojë këto parakushte:

1. Agjencioni duhet të jetë i licencuar.
2. Të ketë fletëdëshminë e kontrollës teknike të autobusëve sipas procedurave ligjore.
3. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e nxënësve, përparësi kanë autobusët me vitin më të ri të prodhimit.
4. Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendorë të ngasësve të autobusëve.
5. Agjencioni duhet të sigurojë perkujdesje mjekësore për nxënësit dhe të ketë dëshmitë (certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që i shoqëron nxënësit.
6. Agjencioni duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e akreditimit të ushqimeve në Shqipëri të vulosur dhe nënshkruar nga pronari i hotelit.
7. Kategorizimi do të bëhet në bazë të kriterëve dhe sigurisë për nxënësit, ku edhe do të vendoset për ofertën dhe vendin e vendosjes së nxënësve (hotelin), nga komisioni përkatës, ditën e hapjes së ofertës.
8. Agjencioni duhet të prezantojë menynë ditore për secilën ditë të qëndrimit në Shqipëri të vërtetuar dhe nënshkruar nga pronari i hotelit.
9. Kontrata në mes të agjencionit dhe hotelit.
10. Një fletëkonfirmim të rezervimit të hotelit përkatës të vërtetuar në mes të kompanisë dhe hotelit me datë të caktuar.
11. Licenca e ballos (vallëzimit) e vulosur dhe nënshkruar nga pronari i hotelit, ku nxënësit do të argëtohen.
12. Hoteli ku bëhet akomodimi i nxënësve duhet të ketë shërbimin e sigurimit fizik dhe profesional.
13. Vërtetimi i ATK-së.
14. Agjencioni duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve të deklaruar në ATK, që do të marrin pjesë në shëtitje (ekskursion).
15. Agjencioni duhet t'i mbulojë shpenzimet e vizitave të nxënësve në monumentet historike.
16. Agjencioni duhet të ofrojë dëshmi se në 12 mujorin e fundit ka pasur së paku qarkullim monetar 250.000 euro.

Ofertat të cilat nuk i përmbushin kriteret e kërkuara nuk do të merren në shqyrtim.

- Afati i aplikimit është shtatë (7) ditë nga dita e shpalljes, më 19.04.2023 (ditën e mërkurë).
- Ofertat pranohen në sportelin e DKA-së në Malishevë.
- Hapja e ofertave do të bëhet në ditën e fundit të aplikimit duke filluar nga ora 14:00, në shkollë.

Malishevë

12.04.2023

Gjimnazi "Hamdi Berisha" - Malishevë

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
OIK
Oda e infirmierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

Mbështetur në Vendimin e Këshillit Drejtues 07.04.2023 Kryetari i OIK shpallë:

FTESË PUBLIKE PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË OIK-UT

Ftojme kompanitë audituese të licencuar nga Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar (KKRF), që të paraqesin ofertat e tyre për: **Auditimin e pasqyrave financiare të Odës së Infirmierëve të Kosovës për vitin 2021-2022.**

Objektivat dhe fushëveprimi i punës:

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që të mundësojë auditorin të shprehë një opinion profesional mbi pozicionin financiar dhe të ardhurave e shpenzimeve për periudhën kontabël. Auditimi do të kryhet në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të publikuara nga Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC). Këto standarte kërkojnë që auditori të planifikojë dhe kryejë auditimin për të marrë siguri të arsyshme në lidhje me atë nëse pasqyrat financiare nuk janë të pavërteta. Auditimi përfshin shqyrtimin, në bazë të testimit, të provave që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Kjo gjithashtu përfshin vlerësimin e parimeve të përdorura të kontabilitetit dhe vlerësimeve të rëndësishme të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ofertat e paraqitura duhet të përmbajnë:

- Auditori duhet të jetë një kompani ligjore dhe kredibile e auditimit;
- Auditori duhet të jetë krejtësisht i paanshëm dhe i pavarur;
- Përvojat në auditimin e institucioneve të tjera të ngjashme me OIK;
- CV- të dhe referencat për stafin dhe përvojat e tyre dhe
- Ofertën financiare

Përzgjedhja e auditorit të pavarur bëhet nga Këshilli Drejtues të OIK-ut, pas mbylljes së afatit për aplikim.

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet pranë zyrave të OIK-ut në formë fizike nga ora 09:00 deri në ora 14:00.
Afati i aplikimit është 8 ditë pune nga dita e publikimit në webfaqen e OIK-ut, <http://oik-ks.org/>.

Data e publikimit:
07.04.2023

Kryetare e OIK-ut
Nexhmije Gori

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Kreshnik Dervishaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t "Nexhmedin Nixha" Elektroteknik Gjakovë.

Fatlind Dobruna nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]


- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULË

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues